



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02/ Nr. 7551
Data: 09.09.2022

PROCESVERBAL I DËGJIMIT BUXHETOR NË FSHATIN GORANCË

Procesverbali nga Dëgjimi i katërt Buxhetor në lidhje me Draft Buxhetin e Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2023 dhe parashikimi për vitet 2024-2025, të mbajtur me datën **23.08.2022**, duke filluar nga ora **18:00** në Sh.F.M.U. “Veli Ballazhi” në fshatin Gorancë, me gjithsej 30 pjesëmarrës, prej tyre 25 burra dhe 5 gra. Nga ekzekutivi, të pranishëm ishin Nënkrjetari i Komunës, **z.Sevdi Dernjani**, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa znj.Lindita Ballazhi, si dhe drejtorët e drejtorive.

Takimin e kryesoi Nënkrjetari i Komunës z.Sevdi Dernjani, i cili iu uroi mirëseardhje të pranishmëve që kishin gjetur kohë për të ardhur në dëgjimin buxhetor për prezentimin e draft buxhetit të Komunës Hanit të Elezit për vitin 2023, si dhe parashikimi për vitet 2024-2025, ku për rend të punës, ishte:

1. **Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2023 dhe parashikimi për vitet 2024-2025**
2. **Diskutimi**

Sevdi Dernjani: Pa humbur kohë, fjalën ia jap Drejtoreshës për ta prezentuar draft buxhetin.

1. **Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2023 dhe parashikimi për vitet 2024-2025**

(Drejtoresha Lindita Ballazhi përshëndet dhe falënderon të pranishmit për pjesëmarrje në dëgjim buxhetor)

Lindita Ballazhi thekson: Çka nënkuptojmë me termin buxhet? Ashtu sikur në jetën private, çdo individ me të hyrat që inkason, bën një planifikim për kostot e tij të jetës, për veshmbathje, për ushqim dhe shpenzime të tjera. I njëjtë është rasti edhe për buxhetin komunal, ku planifikohen të hyrat e shpenzimet. Buxheti paraqet një instrument mjaft të rëndësishëm financiar në të cilin specifikohen të hyrat dhe shpenzimet për një periudhë të caktuar kohore një vjeçare, duke filluar nga 1 janar deri në 31 dhjetor. Planifikimi i Buxhetit Komunal kalon nëpër disa faza, bazuar në Ligjin Nr.03/L-48 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Planifikimi buxhetor fillon me lëshimin e Qarkores së parë Buxhetore nga Ministria e Financave

që bëhet së fundi deri me 15 maj. Faza e dytë është hartimi i KAB-it në bazë të Qarkores Buxhetore ku kemi kufijtë fillestarë buxhetor. Për hartimin e KAB-it ne kemi mbajtur konsulta me asamblesë komunale, dëgjime buxhetore me qytetarët, si dhe është bërë miratimi i KAB-it në Kuvend Komunal më 30 qershor. Faza vijuese është pranimi i Qarkores së dytë Buxhetore nga ana e Ministrisë së Financave, e cila lëshohet më 15 gusht dhe më pas kemi bërë përgatitjen e draft buxhetit, si dhe vijon mbajtja e dëgjimeve publike. Faza përfundimtare e planifikimit buxhetor është miratimi i draft buxhetit në Kuvend Komunal, dhe veprimi i fundit është dorëzimi i draft buxhetit në Ministri të Financave deri më së voni 30 shtator. Buxheti i komunës përfshin këto struktura të financimit, ku për vitin 2023 do të jenë: granti i përgjithshëm (1,431,545€), granti specifik për arsim (993,487€), granti specifik për shëndetësi (364,561€) dhe të hyrat vetanake komunale (560,121€). Pra, buxheti total për vitin 2023 do të jetë 3,349,714€. Në vazhdim, kemi bërë planin e ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale për vitin 2023, siç e shihni në projektor, këtu kemi të përfshime drejtoritë komunale, shëndetësinë dhe mirëqenien sociale, si dhe arsim dhe shkencë. Ndarja e buxhetit është bërë në bazë të kufijve buxhetor, për çdo kategori buxhetore: paga dhe shtesa, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere, si dhe shpenzime kapitale. Nëse e krahasojmë me vitin e kaluar, kemi një rritje të dukshme në të gjitha kategoritë buxhetore. Mandej vijojnë të gjitha projektet kapitale të cilat i keni para vetes tuaj në letër, të cilat janë planifikuar nga drejtoritë dhe ekzekutivi, si dhe disa janë marrë edhe nga dëgjimet paraprake që kemi pasur në qershor dhe nuk po ju detajeve. Nëse keni ju ndonjë projekt propozim apo kërkesë, mundeni ta parashtroni.

2. Diskutimi

Sevdi Dernjani: Pas prezentimit nga Drejtoresha, e shpall të hapur diskutimin interaktiv, çkado që keni ide ose propozim.

Shefket Lusnjani: Si administrator i fshatit Gorancë, Rezhancë dhe Hunel, ne së bashku kemi listu disa prioritete për vitin 2023-2025:

- 1) Prioritet kryesor është kanalizimi në pjesën perëndimore prej te varrezat deri te pompa e cila e furnizon fshatin me ujë, e ku dihen pasojat që i kemi pasur gjatë këtij viti – nga ndotja e ujit.
- 2) Rrym duhet të kyçet nga rrjeti i xeherores ACHRO. Kërkesa është bërë për trafon (prej nesh edhe nga komuna), e cila është dorëzuar në KEDS-Ferizaj. Duhet t’iu bëjmë presion stafit të xeherores të na mundësojë kyqjen në rrjetin e tyre sepse gjatë sezonit të dimrit rrjeti ekzistues është shumë i dëmtuar, e ne edhe ujin e kemi të varur nga uji.
- 3) Në rrugën “Pavarësia”, një lagje e fshatit i ka shtyllat prej drurit dhe janë shumë të dëmtuar-vetëm telat i mbajnë shtyllat. Duhet ë ndërrohen me shtylla të betonit dhe të vendosen kablllo bistek.
- 4) Bypass-rrugë alternative prej Hanit të Elezit në Glloboçicë duhet të largohet nga fshati. Duhet pjesa nëpër fushë të rregullohet si alternative për tu eliminuar kamionat nëpër fshat. Ka shumë lëvizje të komunikacionit nëpër fshat dhe lëvizin fëmijët e shkollës dhe popullata që janë përherë të rrezikuar.
- 5) Asfaltimi i rrugës për Krevenik. Do të jetë një rrugë e cila do të iu shërbejë edhe banorëve të komunës për t’i shfrytëzuar pishat për rekreacion gjatë gjithë kohës, ku ka shumë banorë që e shfrytëzojnë edhe pse rruga është e paasfaltuar.

- 6) Disa rrugica janë pa kubëza. Me kërkesë të banorëve duhet të vendosen edhe pse shumica në fshat është e rregulluar.
- 7) Në fshatin Rezhancë deri te varrezat duhet të bëhet asfaltimi i rrugës me gjatësi 400m.
- 8) Te lagja Huneli , varrezat duhet të rrethohen afërsisht 200m.
- 9) Të përfundohet projekti te varrezat e fshatit Gorancë, të bëhet shtrimi me kubëza të betonit prej te hyrja deri në fund të varrezave, te dera poshtë.

Mbetemi me shpresë se do të merren parasysh prioritetet tona të cilat janë më se të domosdoshme.

Sevdi Dernjani: Një pjesë të madhe të projekteve të paraqitura nga ju, ne veçse i kemi paraparë, siç është ky i shtrimit me kubëza të betonit të rrugicave. Poashtu edhe rruga Krevenik-Gorancë është e parapame, diku në vlerë prej 1 milion e 40 mijë euro, ku edhe vet unë personalisht kam dërgu një shkresë/kërkesë në Ministrinë e Infrastrukturës për me mujt me kalu direkt në buxhet, sepse nuk ka mundësi me u financu e bashkëfinancu një projekt kaq i kushtueshëm prej nesh dhe ministrisë dhe kam kërku nga ata që me u realizu me buxhet të shtetit. Gjithashtu është i paraparë edhe rregullimi i kanalizimeve. Kurse bypass-in e rrugës alternative, e kam shqyrtu dhe nuk është diçka që s'mundemi me e realizu, por një herë me u hap si rrugë e përkohshme, por aty kishte shumë prona private dhe aty e kemi të kufizume ndërhyrjen, dhe një nga zgjidhjet do të ishte që me i marr ju pëlqimet e pronarëve të atyne pronave private.

Hazbi Berisha: I kam dy propozime, një është për mbjelljen e pishave dhe e dyta te vendi Gjurë me e bo një vend rekreativ ose naj pishinë si formë liqeni.

Azem Bajramaliu: Për me u shtru rrugë diçka në fshatin Rezhancë, se ka disa mungesa.

Lindita Ballazhi: Te lista e projekteve që keni para vetes, tek pika 11 është paraparë ndërtim dhe asfaltimi i rrugëve në fshatra dhe këtu përfshihet edhe fshati Rezhancë. Gjithashtu keni parasysh që këto janë projekte në vazhdimësi, nuk janë vetëm për 2023.

Sara Berisha: Ma herët te ambulanta ka qenë një park po që është shkatërru shumë. Kisha propozu që me u rregullu një hapësirë e tillë dhe me u monitoru me kamera, ku kapet edhe AMF-ja edhe parku, shkak i personave të pandërgjegjshëm që shpesh po shkatërrojnë objektet.

Sevdi Dernjani: Kjo çështje është diskutu edhe më herët nga ekzekutivi, madje u mendu që me u nda pjesa veçmas e parkut dhe veçmas e AMF-së. E ke tek pika 25 e listës së projekteve.

Kimete Kuka Hasallari: Rregullimi i kësaj pjese është një kërkesë e vazdhueshme nga banorët, e gjithashtu edhe vendosja e kamerave sepse pikërisht kjo zonë po demolohet jashtëzakonisht shumë edhe shpesh nga njerëzit. Po që gjithsesi e kemi në planifikimet tona rregullimin e parkut dhe vendosjen e kamerave.

Hazbi Berisha: Ndonjë fitness park ose diçka të tillë, a mund të parashihet? shkak se ka shumë të ri që s'kanë me çka merren, së paku të kenë një vend ku të kalojnë kohën e që është edhe e shëndetshme.

Sevdi Dernjani: Edhe kjo e fitnes park përfshihet te kjo pika 25 për rregullimin e ndërtimin e zonave rekreative në fshatin Gorancë.

Rashid Lusnjani: Unë propozoj që të hapet një rrugë të cilën e kemi shfrytëzuar në kohën e luftës së UÇK-së, prej te varrezave deri te lapidari i Xhevdet dhe Feriz Gurit dhe ka rëndësi historike për ne. Por ajo rrugë u bë e pakalueshme dhe do të kishte qenë mirë që me u pastru edhe me u hap si rrugë, qoftë edhe vetëm me zhavor, por që të jetë e kalueshme.

Sevdi Dernjani: Ne po e marrim si propozim, megjithatë në fillim do t'i marrim prioritetet siç është kjo rruga bypass, por nëse bëhet rregullimi i kësaj prrockës afër kësaj rruge, mundemi me rregullu diçka edhe te rruga që thu ti.

Sevdi Dernjani: A ka edhe dikush diçka me shtu apo me plotësu? Nëse nuk ka, e shpall të mbyllur dëgjimin buxhetor në fshatin Gorancë.

Mbledhja përfundoi në ora 18:37.

**Procesmbajtësja
Liridona Ballazhi**

